# DËSHMI ARKIVI

**A-464868**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Melania Trump flet si rrallëherë për Trump: "I them gjithmonë të vërtetën, edhe pse ndonjëherë nuk i pëlqen" |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/lifestyle/melania-trump-flet-si-rrallehere-per-trump-i-them-gjithmone-te-vertete-i588043` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 24 shtator 2026, 07:45:32 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 24 shtator 2026, 07:40:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `374852a87b850292eccd1cbd3d6746f0a88737fd66da4f99ea48bf38b8673a8c` |
| TEKSTI | `cd4092a8efb42aff76737e51e84b5362eda6541d59e47007aedd58463df414c3` |
| PAMJA | `6d35480a23ac22fdf4611edb1b004d27500003385fe4ec7bd74377f3b68df7c7` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `29fa948aed2bc61e09ec89fe46ca28f48c8273fd73ce404db8fbaa08ec755739` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `1057a6098f5231b1a7fb769cdeef6f94e5e01b8f35ccfb6287a805b5f635f739` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/29fa948aed2bc61e09ec89fe46ca28f48c8273fd73ce404db8fbaa08ec755739`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Melania Trump flet si rrallëherë për Trump: "I them gjithmonë të vërtetën, edhe pse ndonjëherë nuk i pëlqen"

24 Shtator 2026, 09:40Lifestyle TEMA



FOTO/ Melania Trump flet rrallë për bashkëshortin: "Ndonjëherë nuk do të dëgjojë të vërtetën që i them"

Zonja e Parë e SHBA-së, Melania Trump, ka folur për bashkëshortin e saj, presidentin Donald Trump, gjatë një interviste për "Fox & Friends", duke dhënë një vlerësim të rrallë për mënyrën se si ai po e përballon mandatin e dytë në Shtëpinë e Bardhë.

E pyetur se si e sheh Donald Trump në mandatin e tij të dytë, Melania tha se presidenti është shumë i përqendruar dhe ka shumë përgjegjësi mbi vete.

"Është shumë i përqendruar, ka shumë gjëra në mendje. Është shumë ndryshe, ajo që po ndodh në botë tani. Por mendoj se po bën më të mirën që mundet", u shpreh ajo.

Melania shtoi se bashkëshorti i saj punon pa pushim dhe se ka shumë energji.

Gjatë intervistës, ajo foli edhe për mënyrën se si i jep mendimin e saj Donald Trump pas fjalimeve apo intervistave të tij.

Pasi moderatori Brian Kilmeade e pyeti për fjalimin e presidentit në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, Melania tha se i kishte thënë se kishte bërë një paraqitje të mirë.

"I thashë se kishte një mënyrë shumë të mirë të të folurit, se bëri shumë mirë dhe se ishte një fjalim i shkëlqyer", tha ajo.

Por më pas bëri një deklaratë që tërhoqi vëmendjen.

"Unë i them të vërtetën. Ndonjëherë ai nuk dëshiron të dëgjojë atë që i them, por është në rregull. Unë gjithmonë them të vërtetën", u shpreh Melania.

Komentet e saj u bënë gjatë një interviste ku ajo foli edhe për nismën e saj "IMPERIA", që synon të mbështesë gratë në pozicione drejtuese.

Melania zbuloi gjithashtu se po përgatitet një seri e re dokumentare për jetën e saj, e cila pritet të jetë më personale se dokumentari i mëparshëm.

Sipas saj, në këtë projekt do t'u përgjigjet edhe disa pyetjeve personale që publiku nuk i ka dëgjuar më parë. Seria pritet të publikohet gjatë muajit nëntor, megjithëse ende nuk ka një datë zyrtare.

Burimi: Fox News

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Pas vdekjes së Dolly Parton plas sherri për trashëgiminë saj, menaxheri akuzon nipin e këngëtares për kërcënime

09:00 Lifestyle

[15 vite burg për Harvey Weinstein, ish-producenti i Hollywood-it dënohet për sulmin seksual ndaj asistentes në 2006-ën]

22:55 Lifestyle / 1 koment

[Miliarderët po kërkojnë mënyra për të jetuar përgjithmonë, fizikani i njohur: Është humbje kohe]

17:00 Lifestyle / 3 komente


FOTO/ Këngëtarja shqiptare nuk kursehet me pozat provokuese, shfaqet me bikini minimaliste

15:55 Lifestyle / 6 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.